



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXII-të (njëzetedy - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 06 qershor 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkollli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, Shefqet Ismajli nga Stacioni i Policisë në Podujevë, Rayan Scherb dhe Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE, Attila Csehi përfaqësues i KFOR, Fatlume Rexhepi pjesëmarrëse.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj punë të mbarë, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po i lexoj pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njësëri me 9 vota Për, nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Komunitete të mbajtura më: 06 mars 2024; 03 prill 2024; 08.05.2024.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, në këtë pikë kemi 3 procesverbale të Komitetit për Komunitete nga tri mbledhjet e kaluara të Komitetit, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth tyre, nëse jo atëherë i hedh në votim një nga një sipas radhës.

Pas votimit kryesuesi i komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota për, miratohen pa vërejtje apo plotësim ndryshime procesverbalet përkatëse të Komitetit për Komunitete nga mbledhjet e mbajtura më 06.03.2024; 03.04.2024; 08.05.2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje .

2. Informatë rreth vizitave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete në shkollat e Komunës së Podujevës ku vijojnë procesin mësimor nxënësit e Komuniteteve jo shumicë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e paraqiti Informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, e falënderoj shumë z.Liman Zeqirin shëf i ZKKK në Komunën e Podujevës, për punën e palodhshme të cilën e ka bërë në vizitat në shkolla ku ka qenë vetëm me znj.Shkurte Sejdiu kurse anëtarët tjerë të Komitetit nuk janë bashkangjitur atyre për vizita në shkolla. Pra gjithë këtë e kanë bërë vetëm këta dy persona dhe në një rast te këto shkollat këtu afër i jam bashkangjitur edhe unë. Është një punë serioze dhe në interes të komunitetit që të bëhet verifikimi i nxënësve të shkollave se si është gjendja e tyre por është dashtë të shkojnë edhe anëtarët e tjerë të Komitetit por disa po vijnë vetëm formalisht sa për tu nënshkruar dhe marr mëditjen, asgjë tjetër, prandaj e theksoi edhe njëherë që i falënderoj këta dy persona për punën që i kanë bërë dhe në bazë të informacioneve të tyre i kam edhe shënimet sepse unë nuk kam qenë në vizitat përkatës për arsye familjare.

Në bazë të informatave që posedoj për çka besoj se më gjerësisht do të na informoj edhe z.Liman Zeqiri sepse ka informacione më shumë, kurse unë vetëm po i lexoj disa nga ato që i kemi këtu.

Më 13 maj 2024 është vizituar shkolla “Ibrahim Rugova” në qytet dhe sipas raportit që e kam e kanë braktisur shkollën Ismajl Sejdiu në klasën e V-të, Vedat Sejdiu në klasën e IX-të rast i cili më ka prekur shumë dhe është për keqardhje sepse në vitin e fundit të braktiset shkollimi nuk di çfarë të them, dhe nuk e di komisioni përkatës që është për këtë çështje a ka marr ndonjë vendim apo kontaktuar me prindin e këtij nxënësi, sidomos për këtë rast lus anëtarin e Komitetit znj.Shkurte Sejdiu të merret me këtë si rast sepse unë këtë nxënësi nuk po e njoh dhe do të doja disa sqarime se çfarë është kjo gjendje ngase po të ishte në klasën e V-të mund të themi që është i pavetëdijshëm apo diçka të ngjashme, por në klasën e IX-të me braktis shkollën është për keqardhje shumë, pastaj kemi edhe nxënësi të klasës së V-të që është Kumrije Halili e cila ka shkuar në migrim dhe nuk mund të themi që është braktisje sepse atje sigurisht që do ti bashkëngjitet shkollimit.

Në shkollën e cekur janë 66 nxënësi të cilët kalojnë mirë të gjithë dhe nuk kanë kurrfarë problemesh mes vete apo më gjerë për çka kemi biseduar edhe me drejtorin e shkollës ku është theksuar se shumë mirë kalojnë nxënësit dhe nuk kemi ndonjë problem.

Me 14 maj është vizituar shkolla “Shaban Shala” në qytet ku në këtë shkollë janë vetëm 8 nxënësi të komunitetit jo shumicë dhe nuk ka braktisje të nxënësve në këtë shkollë por të gjithë vijojnë shkollimin dhe trajtohen mjaft mirë sikurse të gjithë të tjerët, pra nuk ka kurrfarë problemi.

Po ashtu më 14 maj 2024 kemi vizituar edhe shkollën “Naim Frashëri” në qytet dhe në këtë shkollë janë 70 nxënësi të komunitetit jo shumicë dhe po ashtu në këtë shkollë ka braktisje të nxënësve ku i kemi dy raste e që edhe këtu duhet të vërtetohet sepse kemi të bëjmë me nxënësi të klasës së VIII-të e që sipas meje klasa e VIII-të dhe IX-të më së shumti ka ngecje. Në këtë vizitë kam marr pjesë edhe unë personalisht ku kanë qenë edhe kujdestarët e klasës dhe anëtarët tjerë, ku një prej tyre kemi arritur të kthejmë por sërish e ka braktisur shkollën. Po ashtu kemi edhe një nxënësi të klasës së VIII-të që është Hetem Bajrami i cili edhe pse është në lagjen ku jetoj unë dhe përkundër që kam biseduar me prindërit e tij dhe sërish nuk kam mund të bind nxënësin sepse kryesorja është që po dalin për të punuar, andaj një fëmijë të dal të punoj kurse në anën tjetër ta lë shkollimin vërtetë është për keqardhje, ndërsa nxënësit Elvira Ahmeti, Nevzat Bahtiri dhe Kumrije Bahtiri kanë shkuar në migrim. Vlen të përmendet se në këtë shkollë një nxënësi i komunitetit jo shumicë ka arritur të bëjë një film, unë kam qenë i pranishëm dhe e kam parë atë dhe më ka lënë përshtypje shumë të madhe trajtimi i cili është bërë për komunitetin posaçërisht. Vijimi i mësimeve të komuniteteve dhe puna e fëmijëve të cilit janë të detyruar edhe të vazhdojnë mësimin edhe të punojnë është mirë dhe më sa kam informacion unë ai film do të shkoj edhe në Doku Fest.

Me 15 maj 2024 e kemi vizituar shkollën “Ali Ajeti” në fshatin Sfeqëlnë të cilën janë 5 nxënës të komunitetit jo shumicë dhe në këtë shkollë nuk ka braktisje dhe janë të trajtuar mirë ata nxënës të cilët janë duke vazhduar mësimin pa ndonjë problem.

Po më 15 maj 2024 është vizituar edhe shkolla “Luigj Gurakuqi” në fshatin Batllavë ku në këtë shkollë janë 9 nxënës të komunitetit jo shumicë ndërsa braktisje nuk ka në këtë shkollë por janë duke e vazhduar mësimin normalisht dhe pa probleme.

Pas kësaj po në të njëjtën datë është vizituar edhe shkolla “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan ku po ashtu të gjithë nxënësit trajtohen mirë dhe në mënyrë të barabartë si dhe nuk ka braktisje.

Pra kjo ishte informatë e shkurtër sa i përket vizitave në shkollat ku ka nxënës të komunitetit jo shumicë. Unë personalisht kam qenë paksa i involvuar në këtë pjesë sepse rastin ashtu e kam pasur në familje, andaj e përsëris se me keqardhje e them që anëtarët e këtij Komiteti nuk janë bashkëngjitur vizitave për që e gjithë barra i ka mbetur shefit të ZKKK z.Liman Zeqirit dhe anëtares së Komiteti znj.Shkurta Sejdiu që kanë pas shumë punë dhe angazhim.

z.Florent Hasani, theksoi, dëshiroj të di se në fshatin Orllan sa është numri i nxënësve të komunitetit jo shumicë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket fshatit Orllan nuk kam shënime se sa nxënës të komuniteti janë por besoj që z.Liman Zeqiri i ka shënimet dhe mund të na informoj. Shënimet unë i kam marr nga znj.Shkurte Sejdiu sepse unë kam qenë në vizitë vetëm në shkollat “Naim Frashëri dhe Shaban Shala” këtu në qytet kurse të gjitha punët tjera dhe vizitat në shkollat përkatëse nëpër fshatra i kanë kryer siç e cekta z.Liman Zeqiri dhe znj.Shkurte Sejdiu, prandaj besoj që detajet tjera lidhur me këtë proces do të na jap shefi i ZKKK-së z.Liman Zeqiri.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, e kam për detyrë dhe jam anëtar i kësaj ekipe për mos braktisje të nxënësve nga shkolla ku në këtë pozitë më ka caktuar drejtori i Drejtorisë së Arsimit.

Përveç kësaj kam marr pjesë edhe në shkolla tjera që nuk ka nxënës të komunitetit jo shumicë e që ka braktisje të nxënësve nga shkolla edhe nga komuniteti shumicë dhe këtë rol apo punë e kam kryer dhe e kam bërë me shumë kënaqësi ku njëkohësisht e kam edhe detyrë.

Unë faktikisht nuk dua që këta t’i liroj anëtarët tjerë të këtij Komiteti por mund të themi që kanë pasur angazhime të tjera, megjithatë puna ka përfunduar dhe kjo është më e rëndësishmja, edhe për mos pjesëmarrjen e këtyre e theksova që ka raste që janë të angazhuar mirëpo çdo gjë ka ecur më mirë. Përveç kësaj e falënderoj znj.Shkurte Sejdiu e cila më është bashkëngjitur dhe kemi shkuar së bashku në mënyrë direkte e që informacionet janë më të mira dhe më të sakta kur i merr aty në vend të ngjarjes sepse të gjitha shkollat e kanë ekipin e tyre me vendim që të merren me rastet e mos braktisjes dhe regjistrimin e fëmijëve. Pra muaji maj ka qenë jashtëzakonisht me rëndësi sepse ne e dimë që në muajin qershor fillon regjistrimi i fëmijëve parashkollor dhe para fillor.

Tema jon kryesore ka qenë që të ngritët vetëdijesimi sa i përket regjistrimit të fëmijëve në mënyrë që t’i dërgojnë në parashkollor sepse në parashkollor jam i bindur që edhe te komuniteti shumicë nuk i dërgojnë shumicën e fëmijëve e që është edhe obligative dhe është mirë sepse parapërgatiten për ciklin që vjen pra për fillimin e shkollës që nënkupton klasën I-rë, megjithatë ne kemi bërë thirrje në emër të Komitetit për Komunitete dhe në emër të Drejtorisë së Arsimit që të bëhet regjistrimi i fëmijëve me kohë që është muaji qershor.

Në vizat që kemi bërë nëpër shkolla nuk dua që t’i përsërisë ato që i potencoj Kryesuesi i Komiteit paraprakisht por ashtu qëndrojnë, kemi kontaktuar me drejtorin në shkollën “ Dr Ibrahim Rugova” ku ka marr pjesë edhe ekipi që ka qenë i ngritur për parandalimin dhe mos braktisjen e nxënësve nga shkolla, normal ka qenë edhe psikologu i cili luan një rol mjaftë të rëndësishëm dhe aty gjithçka është e qetë si dhe qendra për mësim shtesë vazhdon. Ka edhe nxënës të komunitetit shumicë që nuk vijnë me kohë, ndërsa vështërsi kanë mirëpo vetëm një është që nuk e vazhdon

mësimin e që edhe znj. Shkurte Sejdiu ka qenë prezent dhe ka biseduar me prindërit dhe familjen e tij por nganjëherë moshë adoleshente sjell problematikë për të biseduar sepse duhet të jetë prezentë edhe psikologu, pra e kemi pyetur atë nxënës i cili ka theksuar që ka dal nga ajo moshë dhe kërkon punë, sepse ndoshta i'u nevojiten mjete financiare më shumë se atë që është në moshë më të re.

Sa i përket rastit të Linda Behluli është në klasë të I-rë dhe shkon me vështirësi në shkollë siç është rasti edhe për Muhamedije Halili, por nuk e kanë braktis shkollën, pastaj Ismajl Sejdiu dhe Kumrije Halili nuk e kanë braktisur shkollën por vetëm kanë mungesa, pra herë pas herë nuk shkojnë në shkollë, ndërsa nxënësi i klasës IX-të me emrin Vedat po e ka braktisur shkollën por jemi në përpjekje për ta rikthyer edhe pse është fundi i vitit shkollor, por shkolla fillore është obligative dhe prindi mund të ketë probleme dhe mund të sanksionohet sepse për këtë është në fuqi ligji i cili obligon fëmijën të vijoj shkollën fillore por është edhe përgjegjësi zinxhimore e kujdestarit, prindërve, Drejtorisë së Arsimit se përse nxënësi nuk e vijon mësimin në shkollën fillore. Ne jemi në përpjekje edhe me drejtorin e shkollës të cilin e falënderoj shumë z. Sheqir Krasniqi i cili ka theksuar se është në përpjekje për ta bindur që së paku vitin e fundit të përfundoj ai nxënës. Është lagjia në rrugën "Xhafer Meta" ku numri i nxënësve të komunitetit jo shumicë është më i lartë përveç kësaj kemi edhe Qendrën e mësimin shtesë e cila funksionon dhe gjithçka është në rregull dhe janë të regjistruar 32 djem dhe 34 vajza.

Në shkollën "Shaban Shala" në qytet kemi kontaktuar drejtorin e shkollës z. Nystret Ismajli dhe gjithashtu Sekretarja e shkollës na ka jap informacione të sakta, janë 8 nxënës (2 djem dhe 6 vajza) të komunitetit jo shumicë, mësimi është në nivel dhe nuk ka braktisje të shkollimit nga nxënësit.

Në këtë shkollë më datë 10.05.2024 ka filluar mësimi shtesë ku tutorë është Lirdona Babatinca Maqedonci, mësimi është duke vazhduar dhe është mirë që funksionin ajo Qendër sepse edhe objekti është rregulluar dhe ambienti apo hapësira tash për momentin është më e mirë dhe jemi shumë të kënaqur për këtë.

Te shkolla fillore "Naim Frashëri" në qytet kemi probleme, kemi vizituar bashkërisht si grup, dhe ashtu siç e theksoi Kryesuesi i Komitetit ashtu qëndron, kemi rastin e Rabije Lahu që është në klasën e 8-të dhe Hetem Bajrami e 8-të po ashtu, moshë që e kanë braktis shkollën normale që nuk është e mirë, edhe pas bisedimeve që janë bërë me prindërit e tyre, me ekipin e shkollës dhe me drejtorin e shkollës, por mendoj se nganjëherë është mirë që të ketë edhe sanksione sepse ka raste kur thotë nxënësja që unë kujdesem për ndonjë familjar dhe nuk mund të vazhdoj shkollimin, rasti tjetër lajmërohet me gjendje të rëndë ekonomike dhe patjetër duhet të dal të punojë, pra këto janë raste të ndjeshme. Përveç kësaj i kemi edhe tri raste apo nxënës të cilët kanë migruar, në fakt kemi dy lloje migrimesh, pra ne po kemi edhe migrim të brendshëm dhe migrim të jashtëm apo jashtë shtetit, migrim i brendshëm nënkupton daljen nga komuna në komunën tjetër, ndërsa sa i përket migrimit të jashtëm te ky rast janë 3 anëtarë të familjes së Alushit që kanë shkuar në Gjermani dhe shpresoj që të gjejnë vetën atje sepse kushtet e jetës i kanë të rënda dhe ndoshta do t'i përmisojnë kushtet dhe do të stabilizohen në të ardhmen.

Në shkollën "Ali Ajeti" në fshatin Sfeçël janë 5 nxënës (3 vajza dhe 2 djem) ku të gjithë janë të shkëlqyeshëm, aty edhe Çerdhja është funksionale e cila më ka lënë mendim të mirë ku ishin 40 nxënës dhe 10 punëtor, por ka edhe të komunitetit jo shumicë dhe trajtimi i tyre është në mënyrën më të mirë të mundshme.

Në shkollën "Luigj Gurakuqi" është një nxënës me emrin Meda ku edhe vet kam pasur takim me atë djalë dhe kam biseduar por ai mungon nga pak dhe është në klasën e V-të, pra në këtë shkollë janë 9 nxënës të komunitetit jo shumicë (3 vajza dhe 6 djem) ka vështirësi nga pak por e vazhdojnë procesin mësimor herë pas herë.

Sa i përket shkollës “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan, është diçka tepër e mirë ku nxënësit janë shumë aktiv, procesi shkon shumë mirë dhe nuk ka braktisje, pra në këtë shkollë janë 8 nxënës (5 vajza dhe 3 djem) dhe është kënaqësi të shkosh dhe t’i vizitosh se në çfarë niveli janë e që më kanë lënë shumë përshtypje.

Unë dua të ngriti një çështje sa i përket fshatit Sfeqël, drejtori i shkollës së këtij fshati më ka kërkuar që nuk ka ardhur familja e Turrec Rexhepit i cili publikisht po e them se dy here ka qenë përfitues nga donacionet e Bashkimit Europian përmes IOM e që për projektet e përfituara është paraparë me kontratë se në shumë 200€ ti ndihmohet ndokujt falas me ato mjete sepse mjetet janë deri në 5,000.00€ vlerë, por ai sërish ka qenë përfitues i grandit shtesë në bazë të kontributit të tij që ka bërë 3,800.00€ deri 4,000.00€ falas ka punuar, pra e ka bërë rrethimin e komplet xhamisë së fshatit Sfeqël, ndërsa materialin e kanë blerë komuniteti i fshatit, andaj në vizitën që i është bërë nga përfaqësues të BE që implemtojnë projektet e grandeve, ata janë nderë pa koment tepër mirë dhe falë kësaj ka përfituar edhe donacion tjetër shtesë.

Kam bërë apel tek ato familje që po përfitojnë donacione sepse janë tri vite monitorim të atyre donacioneve se a po funksionojnë me ato mekanizma apo jo, por që shumica e tyre me keqardhje e them se vetëm i marrin mjetet dhe nuk punojnë me ato mjete e që pastaj ne si Komunë po jemi në situatë jo të mirë para përfaqësuesve të BE-së, mirëpo kjo është temë e cila kërkohet të diskutohet. Edhe kjo familja që e ceka e Turrec Rexhepit e ka një kanal për ta hapur dhe për këtë është mirë të merresh edhe ti i nderuar Kryesues i Komitetit, pra një kanal nëpër të cilin kalon lumi që vie nga fshati Lladoc dhe në pronën e tyre kur ka vërshime jua merr oborret, prandaj kërkohet të shtrihen rreth 70 metër gypa, prandaj ta bëjnë një kërkesë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe atë përmes përfaqësuesit të tyre që është z.Xhafer Ademi që është edhe Kryesues i Komitetit për Komunitete, dhe pastaj të shihen mundësitë e rregullimit meqë i dëmtohet prona asaj familje, por që për këtë drejtori i shkollës së fshatit Sfeqël e ka paraqitë këtë problem dhe ka intervenuar që të rregullohet.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, të falënderoj i nderuar Zeqiri për këto informata shtesë sepse gjithëherë ke pas synime të tilla të mira.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, lidhur me nxënësin Vedat Sejdiu unë kam biseduar me atë i cili gjendjen e ka shumë të rëndë dhe është vetëm me një prind i vetëm, por më ka premtuar se do të vazhdoj shkollimin meqë i ka mbete vetëm klasa e IX-të. Po ashtu ka munguar sepse ka qenë me disa probleme shëndetësore por që braktisje sipas tij nuk ka bërë por vetëm ndërprerje të përkohshme. Pra ky djalë është i Remzi Sejdiut.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, duhet t’i bëjmë disi me këtë nxënësin në mënyrë që të mos e humbë klasën e IX-të, mund të bisedojmë me prindin e tij apo të gjejmë ndonjë formë apo mënyrë që ai të vijoj shkollimin.

znj.Fikmete Qurkolli, theksoi, kam një pyetje për z.Liman Zeqirin, dënimi i prindit që nuk e dërgon fëmijën e tij në shkollimin fillor, çfarë dënimi është.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, duke i’u përgjigjur parafolëses theksoi, janë organet përgjegjëse dhe më shumë Drejtoria e Arsimit mund të jap përgjigje në këtë çështje, mirëpo është e vërtetë që mund të sanksionohet prindi në raste të tilla ngase shkollimi fillor i ulët është obligativ, kurse shkolla e mesme e lartë nuk është obligative andaj mendoj se ne këtu çalojmë paksa ngase në Deklaratën e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në Kuadër të procesit të Zgjerimit të Bashkimit Europian e cila është nënshkruar më 05 korrik 2019 nga 7 shtete të Ballkanit ku është edhe Kryeministri i Kosovës, është paksa interesante çështja e arsimit ku thuhet se për arsimin te komunitetet jo shumicë duhet punuar të gjithë zinxhirë që nga prindi, përfaqësuesi i lagjes, Komuna, Zyrat për komunitete dhe deri në Qeveri, do të thotë i gjithë rrjeti

duhet të punoj që vijimi i mësimin obligativ të arrihet deri në 90%, pra kjo është Deklaratë e nënshkruar, ndërsa sanksionet ekzistojnë sepse është obligim dhe kur është obligim sigurisht se merren edhe masa ligjore, ndërsa me këtë Deklaratë në mësimin e mesëm të lartë që nuk është obligative, vijimi i mësimin duhet të arrijë deri në 50%. Mirëpo problemet në këtë janë sepse kemi të bëjmë me çështje tjera siç janë ato ekonomike, sociale, puna, e të tjera që janë çështje të ndjeshme e që pastaj po ndikojnë në braktisjen e mësimin dhe mos vazhdimin të shkollimit, pra obligimi është sanksionim, kurse mos obligimi jo sepse nuk mundesh me zor ta detyrosh të vijoj mësimin në këtë rast. Pra janë organet tjera që sanksionojnë ngase janë fëmijë dhe janë të mitur, kjo është problemi.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë kam marrë pjesë me Qendrën për Punës Sociale dhe unë si përfaqësues e ngrita zërin paksa duke i'u thënë atyre që nëse është e mundshme që atyre prindërve që nuk i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkolla apo që i ndalin nga vijimi në shkollim t'u thuhet se do t'ju ndalin ndihmat sociale, përgjigja e drejtorit ishte që ne mund t'ju themi në një formë por në aspektin ligjor nuk mund t'ju themi dhe nuk mund të ndodh kjo. pavarësisht kësaj ne nëpër disa takime që kemi i'u themi se do t'ju ndalet ndihma sociale në qoftë se fëmijët e juaj nuk shkojnë në shkollë, edhe pse kjo në aspektin ligjor nuk mund të ndodh.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, në mbledhjen kaluar isha paksa i shqetësuar ngase ne njihemi mes vete dhe unë këtë punë dhe këto procese i punojë me vullnetin më të madh dhe këtë e them edhe publikisht sepse është edhe e vërtetë e madhe, me këtë ndërlidhem me zonjën anëtare të këtij Komiteti e cila e hapi një çështje në mbledhjen e kaluar e që tema të tilla normale që diskutohen nëpër takime të ndryshme ku unë jam prezent, ndërsa Komuna e Podujevës është paksa më specifike që na e kanë lakminë edhe Komunitat tjera sepse ne bashkëjetojmë e që vërtetë nuk do të doja të merrem me këto çështje sepse bashkëjetesa jonë më shumë është në aspektin e integritimit dhe të drejtave të njeriut pavarësisht kush është, çfarë kombësie ka, ngjyre, feje apo të ngjashme sepse është e drejtë e jona, ndërsa duke u nisë nga kjo temë ju e dini se egjiptcizmi është paksa temë e rëndë dhe nuk është temë që na përket neve sa i përket bullizimit, ofendimeve, nënçmimeve apo diçka të ngjashme, dhe natyrisht se ka sanksione pastaj nëse veç vijnë në shprehje. Unë kam biseduar drejtpërdrejtë me arsimtarin e cekur në shkollën e cekur dhe më është rrëfyer mua se nuk qëndron ajo çfarë është thënë dhe e potencon se asnjëherë nuk e kam atë fjalorë por përkundrazi thotë se kam respekt për të gjithë nxënësit edhe pse paksa kriteret i kam paksa më të ashpra në proces mësimor me qëllimin më të mirë që nxënësit të arrijnë mësimin siç duhet.

Pra unë në vizitën që kishim atë arsimtar e kam nxjerrë nga salla dhe kam biseduar me të në mënyrën më të sinqertë i cili më tha se jam në gjendje që kudo të dëshmoj se nuk kam përdor shprehje të tilla çfarë është thënë.

Është mirë që në Komunën e Podujevës nuk qëndrojnë këto gjëra sepse pastaj do të mund të ndodhte të bëheshin gjërat e mëdha dhe të merren si shkak. Ne jemi bashkëvendës, bashkëqytetarë dhe nuk kemi kurrfarë të keqe mes vete dhe as nuk kemi pas.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë në një kohë të gjatë rreth 5 vite kam qenë mediator i arsimit duke punuar me një Organizatë që ka qenë "Ballkan Sun flowers" dhe vërtetë në të gjitha shkollat që kemi monitoruar në gjithë Kosovën si mediator të arsimit Komuna e Podujevës ka qenë ndër të parat ku edhe kemi marrë mirënjohje për gjendjen dhe mirëmbajtjen e gjithë nxënësve të komuniteteve jo shumicë të cilët kanë qenë shumë të përkryer, dhe për një kohë shumë të shkurtër kemi arritur të mos ketë asnjë braktisje të shkollimit nga nxënësit e komuniteteve jo shumicë për ato 5 vite që kemi punuar dhe për këtë duke falënderuar edhe 2 Qendrat e mësimin dhe aftësimin shtesë të cilat kanë punuar bukur mirë dhe nuk ka pasë ngecje apo braktisje të shkollimit, kurse tani braktisje ka mirëpo lus që organizatat që janë dhe që merren me

komunitetet jo shumicë të arrijnë ta gjejnë një mediator të arsimit nga komuniteti jo shumicë i cili do t mund të ndikonte shumë në parandalimin e braktisjes së shkollave si dhe regjistrimit me kohë në shkolla nxënësit e komuniteteve jo shumicë. Këtë e them nga përvoja ime sepse më mirë kam qenë i informuar dhe jam marrë unë me nxënës të komuniteteve jo shumicë se sa prindërit e tyre sa i përket procesit mësimor ngase aq mirë i kemi pas raportet dhe data bazat që kemi ditë me saktësi ku dhe si qëndron nxënësi, madje në raste të ndonjë problemi ka ndodh që pas raportimeve të mësimdhënësve brenda ditës është evituar problemi.

Kështu që kemi qenë Komuna më e mirë në tërë Kosovën sa që në një rast nuk më kanë besuar dhe kanë ardhur vetë nga ajo Organizatë të inspektojnë këto çështje dhe kur kemi shkuar dhe kemi hyrë në drejtorët e shkollave dhe atë pa termin janë befasuar, prandaj edhe njëherë po theksoj se do të ishte mirë të jetë një mediator i arsimit nga komuniteti jo shumicë në mënyrë që vërtetë të mund të përcjellë problemet e ndryshme që ndodhin me nxënësit e komuniteteve jo shumicë sa i përket shkollimit dhe procesit mësimor, me theks braktisjet të cilat mund të jenë të rrezikshme.

3. Të ndryshme

znj. Shkurte Sejdiu, theksoi, dua të ngrisë një çështje ku në konkurset zyrtare që po janë në fund të konkurset thuhet që inkurajojmë të aplikojnë komunitetet jo shumicë, mirëpo ka perona të komunitetit jo shumicë të cilët po përfundojnë fakultetin apo edhe masterin, mirëpo di një rast për një peron të komunitetit jo shumicë i cili ka përfunduar masterin dhe ka aplikuar në një konkurs por që ai person është refuzuar për shkak se nuk e paraqit Baçelorin, kurse ai person e ka të përfunduar edhe masterin dhe i ka dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse me aplikacion. Kështu që jam habitur se si ka ndodh kjo kur dihet se masteri nuk mund të kryhet pa e pasur baçelorin, pra përse është refuzuar ai kur e dim se master ka vlerë dhe është gradë më e madhe se baçelor.

z. Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, thënë të drejtën, me keqardhje e them se ne si komunitet jo shumicë në Komunën e Podujevës, deri tani sidomos na është thënë se nuk keni kuadro ku në shumë konkurse nuk kemi arrite të punësohemi me arsyetimin se nuk kemi kuadro, pra njerëz me fakultete, mirëpo tani ka dashtë Zoti kemi disa persona të komuniteteve jo shumicë të cilët e kanë përfunduar fakultetin dhe madje edhe masterin në fusha e drejtime të ndryshme, andaj nuk mendoj se është mirë të mos pranohen në konkurse kur ata aplikojnë sepse nuk jemi numër i madh, shumë pak jemi, prandaj është mirë të pranohen në punë.

Për rastin e cekur tani unë nuk mund ta di gjithë situatën dhe nuk e di kush ka qenë në atë komision që ka bërë një refuzim të tillë dhe ne si Komiteti për Komunitete nuk jemi që mund të ndikojmë në këtë situatë mirëpo çështja në fjalë është mirë të ngritët diku tjetër, sidomos tani edhe një numër i asambleistëve të Kuvendit të Komunës janë prezent këtu dhe për këtë çështje tani veç se u njoftuan dhe duhet të ngritët sepse nëse vërtetë ka një person nga komuniteti jo shumicë i cili ka përfunduar fakultetin dhe masterin duhet të punësohet, madje duhet t'iu jepet edhe inkurajim të tjerëve që ta kryejnë fakultetin dhe të punësohen, e jo t'i shikojnë ata që e kanë përfunduar dhe rrinë në shtëpi të pa punë që do të ishte dekurajim për të tjerët dhe pastaj dalim në pozitë shumë të keqe tek studentët tjerë sepse ata thonë që NN personi e ka kryer fakultetin dhe nuk është punësuar andaj mund të ndodh të ndërprejnë studimet dhe shkollimin dhe të marrin rrugë tjera qoftë edhe duke dalë jashtë vendit në migrim, prandaj këtë çështje e shohë si shumë delikate.

z. Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, tema rreth punësimit është temë e cila vazhdimisht ngritët në diskutime dhe takime të ndryshme që kemi në lidhje me komunitetin jo shumicë.

Më parë ka qenë në shprehje avancimi apo integrimi i komuniteteve jo shumicë mirëpo tani kriteret kanë ndryshuar ku ka konkurrencë të brendshme dhe çdo konkurs që është i hapur nuk shkruan a je apo nuk je komunitet sepse i nënshtrohesh testit me shkrim dhe intervistës me gojë,

pra për një vend pune mund të konkurrojnë shembull 50 persona ose më shumë, mirëpo pastaj është konkurrenca e brendshme, por në rrethana të barabarta mandej i jepet përparësi komunitetit jo shumicë. Dje isha në një takim dhe sa për informacionin e juaj tani Kosovë kemi 55 perona të komunitetit jo shumicë që janë të diplomuar me fakultete e master, 2 e kanë të përfunduar edhe doktoratën, pra ishte çështje e cila u ngritë në nivel nacional dhe ku u paraqiten disa kërkesa për punësim edhe në institucione tjera shtetërore.

Qeveria e Kosovës në këtë vit kishte ndar 250,000.00€ për bursa për student të komuniteteve jo shumicë dhe atë krejt për stimulim në arsim. Tani së fundmi shumë pjesëtar të komuniteteve jo shumicë po studiojnë po diplomojnë dhe po magjistrojnë dhe normale që në procedurë të konkurrimit nëse dikush del më e mirë askush nuk mund t'ia mohoj sepse është një procedurë në këtë proces ku janë komisionet e brendshme dhe askush nga ne nuk mund të merret me ato çështje, por janë edhe procedurat e ankimimit të cilat janë të garantuara për secilin që është palë në procedurë. Ndërsa përparësi në punësim për komunitetet jo shumicë mund të ndodhin në disa institucione tjera siç është Policia ku është një kuotë e caktuar, pastaj është FSK po ashtu dhe mund të ketë edhe ndonjë institucion tjetër që komunitetet jo shumicë mund të kenë përparësi në disa raste në punësim për shkak të kuotës që duhet të plotësohet, kurse te administrata është konkurrencë e brendshme në procesin e punësimit, kjo është sa unë kam informacion rreth kësaj.

Komuna e Podujevës e ka të miratuar Planin e Veprimit për Avancimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë edhe pse ekziston Strategjia përkatëse në nivel qendrorë por që ne si Komunë nga viti 2016 kemi edhe Planin e cekur për çka falënderoj shumë OSBE-në për mbështetje në këto procese sepse më besoni se ka shumë Komunë të cilat ende nuk e kanë të miratuar as Planin e parë e lëre më të dytin e të tretin siç i kemi ne, prandaj mund të them se kjo për neve është rezultat që kemi të miratuar Planin e tretë të tillë, mirëpo është edhe çështja e zbatimit të Planit dhe në kuadër të këtij ne e kemi të ngritur edhe Komitetin Komunal Veprues ku koordinator është drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe jemi të gjithë akterët kryesor në kuadër të këtij Plani duke filluar nga unë si Shef i ZKKK, Drejtorive përkatëse, nga Komiteti për Komunitete e të tjerë i cili është ngritur si rezultat i kërkesave të MAPL-së në funksion të zbatimit apo jo të Planit të lartcekur, pra është Komiteti enkas për monitorimin e zbatimit të këtyre Planeve si dhe normale për raportim pastaj. Megjithatë është çështja tjetër ku ne të gjitha këto po i kryejmë por pastaj po mungon buxheti dhe po lindin probleme mandej në mbulimin e aktiviteteve të parapara për zbatim dhe monitorim të planeve, për këtë as unë si ZKKK nuk kam ndonjë buxhet shtesë për aktivitete të tilla të cilat fillimisht duhet të planifikohen e pastaj të ndahen për ekzekutim, mirëpo duke falënderuar OSBE-në në një bisedë që kemi pasë unë dhe DSHMS kemi ra në dakord që OSBE të na mbështetë me një shumë simbolike në një aktivitet që kemi planifikuar të mbahen 2-3 takime e që për formën dhe mëryen ka mbete që të diskutohet, por është mirë që edhe si Komitet për Komunitete por edhe si asamble komunale që përmes asamblestëve që janë këtu të merret parasysh kjo që e ceka dhe në të ardhmen të kemi buxhet për realizimin e Planeve.

Pra si projekt e kemi paraparë temën “Ofrimi i programeve trajnuese dhe edukative për shëndet dhe higjienë personale”, kjo ngase në vizitat që kam pasë rreth 48 vizita në familjet e komuniteteve jo shumicë, është një numër i madh që kanë nevojë për ndihmë me teknikë sanitare, pra kërkesat kanë qenë për ndërtim të shtëpive, renovim të shtëpive, mirëpo ka numër të madh të kërkesave edhe për sanitari, dhe në bazë të kësaj ne t'i adresohemi nivelit qendrorë apo ndonjë donatori që t'i ndihmojë sepse ne si komunë nuk kemi mundësi buxhetore, e them këtë sepse Qeveria nga ne po kërkojnë punë andaj edhe mjetet buxhetore duhet t'i ndajnë.

Pastaj projekti tjetër është paraparë me temën “Informimi komunitetit jo shumicë rreth mundësive të marrjes dhe llojeve të shërbimeve shëndetësore”, kjo për shkak se QKMF në Podujevë e ka edhe

Ekipin Mobile por që ndoshta ka të tillë që nuk janë të informuar, andaj duhet të njoftohen për këtë dhe për shërbime tjera, të marrin informacione, të marrin numrin e telefonit dhe çështje tjera sa i përket shërbimeve shëndetësore. Ekipi i cekur Mobil është shërbim fals dhe vie mjeku në shtëpi tek pacienti në rastet kur nuk ka kushte apo raste tjera të sëmundjeve dhe trajtohen në shtëpi ata pacientë, mandej janë edhe barnat që janë në listën esenciale që jepen falas por që duhet të informohen komuniteti jo shumicë në rast se nuk janë të informuar, prandaj nga DSHMS do të ftohen 1 apo 2 mjek adekuat të cilët do të bëjnë informimin për këto çështje.

Këto takime do të shohim bashkërisht edhe me OSBE-në por edhe me të tjerët se kur mund t'i mbajmë sepse tani edhe jemi në muajt e verës dhe janë pushimet.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj OSBE-në për mbështetje të vazhdueshme komunitetit jo shumicë dhe jo vetëm, projekti për takime të tilla është shumë ide dhe iniciativë e mirë dhe mendoj se do të ketë sukses sepse sipas asaj që dëgjova temat janë më se të nevojshme.

Takimet mendoj se është mirë t'i mbajmë pas pushimeve, vendtakimet / lokalet dhe një pjesë të organizimeve do t'i siguroj unë kurse tjerat çka janë tuaja si institucione sigurisht se do t'i siguroni ju si Komunë në bashkëpunim me OSBE-në, kështu që ato ligjërata apo informime janë të mirëseardhura për komunitetin jo shumicë në Komunën e Podujevës.

znj. Shkurte Sejdiu, theksoi, sa i përket projektit të cekur paraprakisht vetëm deshta t'ju informoj se Fitore Sejdiu i posedon listat e komuniteteve jo shumicë dhe mund t'i merrni tek ajo në mënyrë që takimet të jenë sa më të një niveli të mirë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, është mirë që ka bashkëpunim të tillë dhe kjo mund të quhet aktivitet dhe të na ndihmon sepse ne i dim por duhet të jenë qytetarët ata duhet të njoftohen se ku duhet dhe ku kanë mundësi të marrin shërbime falas qoftë në shëndetësi qoftë në fusha tjera, prandaj kjo është edhe ajo tema të cilën OSBE e ka iniciuar.

z.Bekim Karaxhija, përfaqësues i OSBE, theksoi, ju falënderoj për interesimin e juaj për këto aktivitete që u ceken dhe për ofrimin e bashkëpunimit nga ana juaj siç janë shefi i ZKKK në Podujevë z.Liman Zeqiri, po ashtu edhe Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.Xhafer Ademi por edhe pjesëtarët dhe zyrtarët tjerë.

Sa i përket këtyre projekteve që i kemi paraqitur si ide, fillimisht ju falënderoj për mirëpritjen e kësaj ideje, ndërsa sa i përket ofrimin të ndihmës nga kolegja që u cek nuk paraqet kurrfarë problemi meqë është e përfshirë në aktivitete mund të bashkëngjitet edhe në këtë.

Ne në fakt veç e diskutuam për këto aktivitete mirëpo ne mund të vijmë një ditë tjetër enkas të bisedojmë vetëm për këtë aktivitet dhe mund të jetë pjesëmarrëse edhe motra juaj znj.Fitore Sejdiu dhe të bisedojmë më gjerësisht.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ju falënderoj të gjithëve dhe nëse nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, mund ta përfundojmë këtë mbledhje.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:55

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0036812/24
Podujevë, 06 qershor 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**